

# 1.

(Hap kapakun e majtë për të zbuluar vetëm gomarin)

Një gomar kishte punuar gjithë jetën për të zotin e tij, duke mbajtur thasë mielli pa u ankuar asnjëherë.

(Hap kapakun në qendër, pastaj të djathtin)

Një ditë ai dëgjoi mullixhiun t' u thoshte miqve të tij :

-Ky gomar është tepër i vjetër, do ta përzë!

Dhe gomari mendoi :

- Dhe unë që po gëzohesha aq shumë që së shpejti do mundja të pushoja këtu ! E mira është që të zhdukem që këtu sa kam akoma kohë. Kam dëgjuar të thuhet që qyteti i Bremenit kërkon muzikantë, atje mund të luaj me bandën e qytetit.

(Tërhiq imazhin ngadalë, deri tek vija, duke bërë të mundur të shohësh njëra pas tjetrës pemët e pyllit)

Kur arriti në pyll, ai dëgjoi dikë që qante.

## 2.

Na ishte një qen gjahu që rrinte shtrirë poshtë një peme. Gomari e pyeti :

- Miku im, pse po qan kështu?

Qeni iu përgjigj :

-Që thua ti, nuk më bëhet më të shkoj për gjah, preferoj të luaj me kafshët në pyll. Por sot në mëngjiz, im zot deshi të më vriste. Ika nga sytë këmbët, e tani jam në hall ku të gjej të ha.

-Hajde me mua ! Kam dëgjuar të thonë që qyteti i Bremenit kërkon muzikantë, kështu që atje ne mund të luajmë me bandën e qytetit.

Dhe që të dy morën rrugën, qeni përpara dhe gomari nga pas.

Befas ata u ndalën se dëgjuan një mjaullimë të trishtuar.

« Les musiciens de Brême », d'après les frères Grimm, récit pour le théâtre d'images kamishibai

Adaptation et illustration : par Ronald Juliet

Përkth Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Traduit par Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Copyright 2008 : Editions Paloma, [www.editionspaloma.com](http://www.editionspaloma.com)

En collaboration avec le Centre de ressources en éducation de l'enfance, CREDE, Av. Figuiers 28 CH-1007 Lausanne, [www.crede-vd.ch](http://www.crede-vd.ch)

Diffusion : Fondation Education et Développement, Av. de Cour 1, CH-1007 Lausanne, [www.globaleducation.ch](http://www.globaleducation.ch)

Impression: I comme imprimeurs SA, Renens, Suisse

### 3.

Ishte një mace që qante

- C'po ndodh kështu ? E pse je kaq e trishtuar ? e pyeti gomari.

- Për fat të keq, u përgjigj macja minjtë janë bërë shumë të këqinj me mua, kështu që preferoj më mirë të rri pranë hirit të zjarrit se sa të merrem me ta. Po kuptohet që kjo nuk i pëlqen hiç zonjës sime që u përpoq të më mbyste sot në mëngjes. Shpëtova paq, por ç' do bëhet me mua tani ?

- Hajde me ne ! Kam dëgjuar që qyteti i Bremenit kërkon muzikantë, atje ne mund të luajmë me bandën e qytetit.

Dhe ja ku morën përsëri rrugën, qeni përpara, gomari nga pas dhe macja që mbyllte rreshtin.

Rruga kalonte para një ferme...

« Les musiciens de Brême », d'après les frères Grimm, récit pour le théâtre d'images kamishibai

Adaptation et illustration : par Ronald Juliet

Përkth Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Traduit par Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Copyright 2008 : Editions Paloma, [www.editionspaloma.com](http://www.editionspaloma.com)

En collaboration avec le Centre de ressources en éducation de l'enfance, CREDE, Av. Figuiers 28 CH-1007 Lausanne, [www.crede-vd.ch](http://www.crede-vd.ch)

Diffusion : Fondation Education et Développement, Av. de Cour 1, CH-1007 Lausanne, [www.globaleducation.ch](http://www.globaleducation.ch)

Impression: I comme imprimeurs SA, Renens, Suisse

4.

Kur dëgjuan një këndez që po këndonte me sa kishte në kokë « Kirikikiiiiii ! Kirikikiiiiii ! »

Hej, na çave daullen e veshit, asnjëherë s' kemi dëgjuar një këndez të këndojë kaq fort !

- Këndoju përderisa mundem akoma. Zotërinjtë e mi kanë vendosur të më ziejnë në tenxhere që të mos mundem ti zgjoj çdo mëngjes ! Kirikikiiiiii ! Kirikikiiiiii !

- Hajde me ne, kam dëgjuar të thuhet që qyteti i Bremenit kërkon muzikantë, mund të luajmë me bandën e qytetit.

« Les musiciens de Brême », d'après les frères Grimm, récit pour le théâtre d'images kamishibai

Adaptation et illustration : par Ronald Juliet

Përkth Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Traduit par Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Copyright 2008 : Editions Paloma, [www.editionspaloma.com](http://www.editionspaloma.com)

En collaboration avec le Centre de ressources en éducation de l'enfance, CREDE, Av. Figuiers 28 CH-1007 Lausanne, [www.crede-vd.ch](http://www.crede-vd.ch)

Diffusion : Fondation Education et Développement, Av. de Cour 1, CH-1007 Lausanne, [www.globaleducation.ch](http://www.globaleducation.ch)

Impression: I comme imprimeurs SA, Renens, Suisse

## 5.

Dhe ja ku morën rrugën, qeni përpara, i ndjekur nga gomari që mbante mbi kurriz këndezin,  
dhe macja që mbyllte rreshtin.

Po ja ku arriti nata.

- Ha jde të fshihemi poshtë pemëve, tha macja.

« Les musiciens de Brême », d'après les frères Grimm, récit pour le théâtre d'images kamishibai

Adaptation et illustration : par Ronald Juliet

Përkth Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Traduit par Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Copyright 2008 : Editions Paloma, [www.editionspaloma.com](http://www.editionspaloma.com)

En collaboration avec le Centre de ressources en éducation de l'enfance, CREDE, Av. Figuiers 28 CH-1007 Lausanne, [www.crede-vd.ch](http://www.crede-vd.ch)

Diffusion : Fondation Education et Développement, Av. de Cour 1, CH-1007 Lausanne, [www.globaleducation.ch](http://www.globaleducation.ch)

Impression: I comme imprimeurs SA, Renens, Suisse

## 6.

Cdonjëri u rehatos sa më mirë të mundej poshtë një peme të madhe.

Këndezi zgjodhi një degë të madhe dhe bërtiti :

- Po shoh drita ! Duhet të jetë një shtëpi !

- Hajde të shkojmë, gogëziti qeni. Kemi kaq shumë uri.

- Ah, sa do më pëlqente të flija në të ngrohtë, tha macja.

Dhe ja ku miqtë tanë morën rrugën.

(Tërhiq imazhin përgjysmë deri në vijën që zbulon gomarin dhe fillimin e dritares)

- Këtë që po shoh, po ma bën mishin kokrra-kokrra !

- Cfarë është ?

(Tërhiq imazhin komplet)

« Les musiciens de Brême », d'après les frères Grimm, récit pour le théâtre d'images kamishibai

Adaptation et illustration : par Ronald Juliet

Përkth Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Traduit par Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Copyright 2008 : Editions Paloma, [www.editionspaloma.com](http://www.editionspaloma.com)

En collaboration avec le Centre de ressources en éducation de l'enfance, CREDE, Av. Figuiers 28 CH-1007 Lausanne, [www.crede-vd.ch](http://www.crede-vd.ch)

Diffusion : Fondation Education et Développement, Av. de Cour 1, CH-1007 Lausanne, [www.globaleducation.ch](http://www.globaleducation.ch)

Impression: I comme imprimeurs SA, Renens, Suisse

7.

- Një skuadër hajdutësh, mermëriti gomari, kanë mbushur thesin me monedha të florinjta dhe po festojnë duke ngrënë e pirë gjithë të mirat !
- Sa do doja dhe unë të vija ndonjë gjë në gojë, tha qeni duke lëpirë turirin.
- Eh ! Sikur të ishim në vendin e tyre, psherëtiu (hoqi) macja
- Kam një ide ! tha këndezi, hajde t' u japim frikën !

« Les musiciens de Brême », d'après les frères Grimm, récit pour le théâtre d'images kamishibai

Adaptation et illustration : par Ronald Juliet

Përkth Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Traduit par Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Copyright 2008 : Editions Paloma, [www.editionspaloma.com](http://www.editionspaloma.com)

En collaboration avec le Centre de ressources en éducation de l'enfance, CREDE, Av. Figuiers 28 CH-1007 Lausanne, [www.crede-vd.ch](http://www.crede-vd.ch)

Diffusion : Fondation Education et Développement, Av. de Cour 1, CH-1007 Lausanne, [www.globaleducation.ch](http://www.globaleducation.ch)

Impression: I comme imprimeurs SA, Renens, Suisse

8.

- Ti qen shko hip në kurrizin e gomarit. Ti mace shko hip në kurrizin e qenit.

Dhe unë, do hipi mbi kokën e maces. Pastaj do këndojmë të gjithë së bashku shumë fort!

Kujdes, po jap sinjalin, një, dy...

« Les musiciens de Brême », d'après les frères Grimm, récit pour le théâtre d'images kamishibai

Adaptation et illustration : par Ronald Juliet

Përkth Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Traduit par Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Copyright 2008 : Editions Paloma, [www.editionspaloma.com](http://www.editionspaloma.com)

En collaboration avec le Centre de ressources en éducation de l'enfance, CREDE, Av. Figuiers 28 CH-1007 Lausanne, [www.crede-vd.ch](http://www.crede-vd.ch)

Diffusion : Fondation Education et Développement, Av. de Cour 1, CH-1007 Lausanne, [www.globaleducation.ch](http://www.globaleducation.ch)

Impression: I comme imprimeurs SA, Renens, Suisse



## 9.

- ...tre !

(Po të dëshironi, u thoni fëmijëve të bërtasin. Hi Hai ! Hum Hum ! Miau ! Kirikikiiii !)

Ata u vërsulën kaq fort drejt xhamit që fluturoi në mijëra copa dhe ata në anën tjetër të dritares brenda në dhomë.

Edhe hajdutët ? Duke kujtuar që kishin të bënë me një monstër, ia mbathën nga sytë këmbët.

« Les musiciens de Brême », d'après les frères Grimm, récit pour le théâtre d'images kamishibai

Adaptation et illustration : par Ronald Juliet

Përkth Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Traduit par Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Copyright 2008 : Editions Paloma, [www.editionspaloma.com](http://www.editionspaloma.com)

En collaboration avec le Centre de ressources en éducation de l'enfance, CREDE, Av. Figuiers 28 CH-1007 Lausanne, [www.crede-vd.ch](http://www.crede-vd.ch)

Diffusion : Fondation Education et Développement, Av. de Cour 1, CH-1007 Lausanne, [www.globaleducation.ch](http://www.globaleducation.ch)

Impression: I comme imprimeurs SA, Renens, Suisse

## 10.

Përgjatë ndonja dhjetë minutave nuk dëgjohej veçse kërcitja e zjarrit, se kafshët ishin aq shumë të zenë me ngrënien e gjithë të mirave, saqë s' kishin kohë të diskutonin.

- Mua do më pëlqente të flija jashtë, pranë pìrgut me pleh, tha gomari.
- Dha mua, prapa derës, tha qeni.
- Mua, tha macja, do rrija me kënaqësi në hirin e vatrës akoma të ngrohtë.
- Do më pëlqente të ngjitesha mu në majë të çatisë, tha këndezi.

« Les musiciens de Brême », d'après les frères Grimm, récit pour le théâtre d'images kamishibai

Adaptation et illustration : par Ronald Juliet

Përkth Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Traduit par Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Copyright 2008 : Editions Paloma, [www.editionspaloma.com](http://www.editionspaloma.com)

En collaboration avec le Centre de ressources en éducation de l'enfance, CREDE, Av. Figuiers 28 CH-1007 Lausanne, [www.crede-vd.ch](http://www.crede-vd.ch)

Diffusion : Fondation Education et Développement, Av. de Cour 1, CH-1007 Lausanne, [www.globaleducation.ch](http://www.globaleducation.ch)

Impression: I comme imprimeurs SA, Renens, Suisse

## 11.

Gjatë kësaj kohe, hajdutët ngrinë së ftohti në pyll. Kryehajduti u tha me një zë të thellë:

- Ah sa budallej që jemi, nuk duhej t'ia mbathnim kështu dhe të linim gjithshka në shtëpi !
- Kjo është shumë e vërtetë, shef, tha një hajdut.
- Dhe tani, që nuk ka më dritë në shtëpi, ti që je më i forti, shko e hidh një sy për të parë se çfarë po ndodh.

(Tërhiq imazhin deri që zbulon hajdutin në errësirë)

Hajduti hyri brenda në majë të gishtërinjve.

- Pa shih, pa shih, kongjijtë e zjarrit janë akoma të ngrohtë. Do t' i ndez që të shoh më mire.

Dhe ai u përkul mbi atë që ndriçonte në errësirë, por....

(Tërhiqe me forcë të gjithë imazhin)

## 12.

Ishin sytë e maces !

Macja iu hodh hajdutit në fytyrë dhe i çorri faqet.

(Tërhiq imazhin deri sa të tregojë hajdutin që po ia mbath)

I frikësuar deri në palcë, hajduti ia mbathi për nga porta. Por...

(Tërhiqe me forcë të gjithë imazhin)

« Les musiciens de Brême », d'après les frères Grimm, récit pour le théâtre d'images kamishibai

Adaptation et illustration : par Ronald Juliet

Përkth Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Traduit par Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Copyright 2008 : Editions Paloma, [www.editionspaloma.com](http://www.editionspaloma.com)

En collaboration avec le Centre de ressources en éducation de l'enfance, CREDE, Av. Figuiers 28 CH-1007 Lausanne, [www.crede-vd.ch](http://www.crede-vd.ch)

Diffusion : Fondation Education et Développement, Av. de Cour 1, CH-1007 Lausanne, [www.globaleducation.ch](http://www.globaleducation.ch)

Impression: I comme imprimeurs SA, Renens, Suisse

## 13.

-Haaam ! Ia bëri qeni duke e kafshuar fort në kofshë

(Tërhiqe imazhin deri tek vija që tregon gomarin dhe hajdutin)

- Hop, merre dhe një të goditur nga patkoi im, që të vraposh akoma më shpejt, tha gomari.

(Tërhiqe me forcë të gjithë imazhin)

« Les musiciens de Brême », d'après les frères Grimm, récit pour le théâtre d'images kamishibai

Adaptation et illustration : par Ronald Juliet

Përkth Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Traduit par Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Copyright 2008 : Editions Paloma, [www.editionspaloma.com](http://www.editionspaloma.com)

En collaboration avec le Centre de ressources en éducation de l'enfance, CREDE, Av. Figuiers 28 CH-1007 Lausanne, [www.crede-vd.ch](http://www.crede-vd.ch)

Diffusion : Fondation Education et Développement, Av. de Cour 1, CH-1007 Lausanne, [www.globaleducation.ch](http://www.globaleducation.ch)

Impression: I comme imprimeurs SA, Renens, Suisse

## 14.

Ndërsa hajduti nuk po mblidhte dot veten, këndezi ia dha me sa i mbante fryma

- Kirikikiiii ! Kirikikiiii !

« Les musiciens de Brême », d'après les frères Grimm, récit pour le théâtre d'images kamishibai

Adaptation et illustration : par Ronald Juliet

Përkth Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Traduit par Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Copyright 2008 : Editions Paloma, [www.editionspaloma.com](http://www.editionspaloma.com)

En collaboration avec le Centre de ressources en éducation de l'enfance, CREDE, Av. Figuiers 28 CH-1007 Lausanne, [www.crede-vd.ch](http://www.crede-vd.ch)

Diffusion : Fondation Education et Développement, Av. de Cour 1, CH-1007 Lausanne, [www.globaleducation.ch](http://www.globaleducation.ch)

Impression: I comme imprimeurs SA, Renens, Suisse

## 15.

Në pyll, hajduti gjeti shokët e tij dhe u tha :

Në atë shtëpi ndodhet një shtrigë e mallkuar që qeshte duke më çjerrë me thonjtë e saj të gjatë. Përpara portës një xhuxh me qime më kafshoi këmbën. Jashtë një gjigant i zi më fluturoi në ajër vetëm me një të goditur. Dhe mbi çati, pashë një djall që hapte krahët e tij gjigante duke bërtitur : Kapeni ! Kapeni !

- Nuk mund të rrimë akoma këtu, urdhëroi kryahajduti. Hajde të shpëtojmë sa më shpejt !

Dhe të gjithë u zhdukën për të mos u dukur kurë më.

E katër muzikantët tanë të Bremenit ?

« Les musiciens de Brême », d'après les frères Grimm, récit pour le théâtre d'images kamishibai

Adaptation et illustration : par Ronald Juliet

Përkth Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Traduit par Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Copyright 2008 : Editions Paloma, [www.editionspaloma.com](http://www.editionspaloma.com)

En collaboration avec le Centre de ressources en éducation de l'enfance, CREDE, Av. Figuiers 28 CH-1007 Lausanne, [www.crede-vd.ch](http://www.crede-vd.ch)

Diffusion : Fondation Education et Développement, Av. de Cour 1, CH-1007 Lausanne, [www.globaleducation.ch](http://www.globaleducation.ch)

Impression: I comme imprimeurs SA, Renens, Suisse

## 16.

A tyre u pëlqeu kaq shumë shëpizëza, sa që u vendosën përgjithmonë aty...

... Nëse një ditë ju bie rruga për nga Brementi, do t'ju bjerë në sy patjetër një shtëpizë ku katër muzikantë jetojnë të lumtur së bashku. Ata do ju ftojnë me siguri të dëgjoni koncertin e tyre :

Hiha ! Hum Hum ! Miau ! Kirikikiiii ! (së bashku me fëmijët)

(Mbyll kanatat e teatrit një nga një)

FIN

« Les musiciens de Brême », d'après les frères Grimm, récit pour le théâtre d'images kamishibai

Adaptation et illustration : par Ronald Juliet

Përkth Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Traduit par Enriketa Kalldrëmxiu Barbey

Copyright 2008 : Editions Paloma, [www.editionspaloma.com](http://www.editionspaloma.com)

En collaboration avec le Centre de ressources en éducation de l'enfance, CREDE, Av. Figuiers 28 CH-1007 Lausanne, [www.crede-vd.ch](http://www.crede-vd.ch)

Diffusion : Fondation Education et Développement, Av. de Cour 1, CH-1007 Lausanne, [www.globaleducation.ch](http://www.globaleducation.ch)

Impression: I comme imprimeurs SA, Renens, Suisse